



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:033406

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06022540

**2024:035025**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit N.J nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh....-Tetovë, i akuzuar për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.1884/23 të dt.30.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 01.08.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, përfaqësueses së të dëmtuarës, A.H...D, dhe të pandehurit, me dt.05.08.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.06.08.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri N. J nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh. ... - Tetovë, i lindur më dt...., nga i ati J... dhe e ëma F..., e gjinisë I..., shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i martuar, prind i 5 fëmijëve, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:...

### ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.11.2023 rreth orës 06:00, në Pikë Kalimin Kufitar në Hani i Elezit, që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut, i pandehuri kalon vijën kufitare nga Maqedonia në Kosovë nuk deklaroi mallrat dhe shmang kontrollin doganor, ashtu që me veturën e markës “VW ...” me targa ... AF, të cilën e drejtonte i pandehuri i cili, ndalet për kontrollë dhe gjatë kontrollit në veturë në pjesën e motorrit të fshehura dhe të mbështjellura i janë gjetur penj me ngjyrë të arit 51 pce me peshë 13.00 kg, litarë nga penj me ngjyrë të arit me gjatësi 8,0m x40pce, me peshë 4,5kg, topta nga penj me ngjyrë të arit në formë litari me gjatësi 0,500 cm 235 pce me peshë 4,3 kg dhe 3 kg mjaltë të gjitha në vlerë prej 220.42 Euro, për të cilat nuk ka poseduar asnjë dokument për prejardhjen e mallit, dhe me këtë veprim i njëjti i është shmangur kontrollit doganor, me ç’ rast Doganës së Kosovës i shkakton dëm material në vlerë prej 65,68 €.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70 dhe 71 par.1 nenpar.1.3, të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **GJYKON**

Me dënim me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € ( dyqind euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’ a paguaje brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe atë në dy kështe mujore.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t’ a zëvendesojë dënimin me gjobë, me dënim me burgim, duke llogaritur shumën prej 20 € per çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në

shume prej 20.00€, te gjitha keto paguhen pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë, në afat te njejte me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri, që të dëmtuarës Dogana e Kosovës, t'i kompenzojë dëmin në vlerë prej 65.68 €.

Në bazë të nenit 311 par. 6 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohen mallrat si në vijim: Penj me ngjyrë të Arit 51 pce me peshë 13.00 kg, litarë nga penj me ngjyrë ari gjatës 8,0 m x40 pce, me peshë 4,5kg, toptha nga penj me ngjyrë arit në formë litari gjatësi 0,500 cm 235 pce me peshë 4,3 kg dhe 3 kg mjaltë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.1884/23 të dt.30.01.2024, të pandehurin N.J nga Rep. e Maqedonisë së Veriut, me adresë banimi në fsh....-Tetovë, e ka akuzuar për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 01.08.2024.

Prokurorja e shtetit, Mimoza Sylja-Hyseni në fjalën e saj, me rastin e prezentimit te aktakuës , deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës se parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës, A. H... D, në fjalën e saj në shqyrtimin fillestar, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe I propozon gjykatës konfiskimin e mallit të përshkruar si në aktakuzë.

I pandehuri ne fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shprehur pendesë të sinqertë për veprimin e tij dhe duke I premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe I kërkon gjykatës, që, duke patur parasysh se është hera e pare që ka kryer vepër penale, me rastin e marrjes së vendimit t'I shqiptohet një dënim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi I fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi I fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh propozimet për rrethanat e lehtësuese dhe rënduese si në aktakuzë, si edhe konfiskimin e mallrave.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur keqardhje dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën penale, i njëjti nuk është recidivist i kësaj apo veprave tjera penale, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveç veprimeve të të pandehurit, të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin N.J, i akuzuar për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla

penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për konfiskimin e mallrave të përshkruar si në dispozitiv, u mor në bazë të nenit 311 par. 6 lidhur me nenin 92 par.1 të KPRK-së

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**2024:035025 datë 06.08.2024**

Sekretarja Juridike  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.